



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.Dh.Shk.II.nr.258/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS—Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtarja Franciska Zhitija Ymeri, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.A. (KESco), me seli në Prishtinë, rr. “Bill Clinton”, nr.5, kundër debitorit MANI-COM Sh.P.K., me seli në Mitrovicë, përfaqësuar me pronar Besart Begu, sipas dokumentit të besueshëm përmbartimor, duke vendosur lidhur me ankesat e debitorit dhe kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.1637/22 të datës 22.06.2023, me datën 19.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pa pathemeltë ankesa e kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.A. (KESco), me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.1637/22 të datës 22.06.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin KPPP.nr.1637/22 të datës 22.06.2023, në pikën I të dispozitiv, e ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit MANI-COM Sh.p.k., me seli në Mitrovicë dhe ka anuluar pjesërisht P.nr.228/19 i datës 14.02.2019, të përmbartuesit privat Atip Mustafa, me seli në Mitrovicë, për pjesën e detyrimi prej 1,196.39 euro, në pikën II e ka refuzuar pjesërisht prapësimin e debitorit MANI-COM Sh.p.k., me seli në Mitrovicë dhe mbetet në fuqi pjesa tjetër e urdhëri përmbartimor P.nr.228/19 i datës 14.02.2019 të përmbartuesit privat Atip Mustafa, me seli në Mitrovicë, sa i përket shumën prej 22,211.87 euro, së bashku me kamatë

ligjore sipas normës së interesit vjetore prej 8% dhe në pikën III ka përfunduar pjesërisht procedurën përbarimore të kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.A. (KESCO), me seli në Prishtinë, ndaj debitorit MANI-COM Sh.p.k., me seli në Mitrovicë, sipas urdhëri përbarimore P.nr.228/19 i datës 14.02.2019, për shumën prej 1,196.39 euro.

Kundër aktvendimit të lartcekur, brenda afatit ligjor, ankesë ka parashtruar kreditori, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës përbarimore dhe kontestimore, të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozimin që të aprovohet ankesa e kreditorit dhe aktvendimi KPPP.nr.1637/22 të datës 22.06.2023 të priset dhe çështja të kthehet në rigjykim apo rivendosje.

Gjykatës Komerciale - Dhomat e shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori me datën 14.02.2019, ka paraqitur propozim për përbarim ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm – Ekstraktit të verifikuar të librave afarist – Nr. DMI-9039357, që në afat prej 7 ditësh të paguaj për shumën e borxhit prej 23,408.26€, për periudhën prej datës 02.11.2015 deri me 18.01.2019, me kamatë ligjore prej 8% si dhe shpenzimet procedurës përbarimore.

Përbaruesit privat Atip Mustafa, me seli në Mitrovicë, me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përbarim të kreditorit ka lëshuar urdhër me të cilin ka lejuar përbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm– Ekstraktit të verifikuar të librave afarist – Nr. DMI-9039357, e cilat paraqet dokument përbaruese në bazë të nenit 29 par.1.2 të LPP-së.

Kundër urdhrit për lejimin e përbarimit, brenda afatit ligjor, debitori ka paraqitur prapësim, duke theksuar se ka skaduar afati kohor brenda të cilit sipas ligjit mund të kërkohet përbarimi për pjesën e borxhit, ngase kërkesa është parashkruar. Gjithashtu se dokumenti i besueshëm sipas të cilit është iniciuar propozimi për përbarim nuk është i përshtatshëm për përbarim, andaj i ka propozuar që ta pranoj prapësimin e debitorit dhe të anuloj urdhërin përbarimor dhe të obligoj kreditorin që ti bartë shpenzimet e procedurës përbarimore.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim, duke theksuar se prapësimi i debitorit është i pa bazuar me asnjë prove dhe dokumenti përmbanë të gjitha elementet e një dokumenti të besueshëm, dhe nuk kemi të bëjmë me parashkrim të borxhit, andaj ka propozuar që të mbetet në fuqi urdhëri përmbarimor.

Gjykata Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin KPPP.nr.1637/22 të datës 22.06.2023, në pikën I të dispozitiv, e ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit MANI-COM Sh.p.k., me seli në Mitrovicë dhe ka anuluar pjesërisht P.nr.228/19 i datës 14.02.2019, të përmbaruesit privat Atip Mustafa, me seli në Mitrovicë, për pjesën e detyrimi prej 1,196.39 euro, në pikën II e ka refuzuar pjesërisht prapësimin e debitorit MANI-COM Sh.p.k., me seli në Mitrovicë dhe mbetet në fuqi pjesa tjetër e urdhëri përmbarimor P.nr.228/19 i datës 14.02.2019 të përmbaruesit privat Atip Mustafa, me seli në Mitrovicë, sa i përket shumën prej 22,211.87 euro, së bashku me kamatë ligjore sipas normës së interesit vjetore prej 8% dhe në pikën III ka përfunduar pjesërisht procedurën përmbarimore të kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.A. (KESCO), me seli në Prishtinë, ndaj debitorit MANI-COM Sh.p.k., me seli në Mitrovicë, sipas urdhëri përmbarimore P.nr.228/19 i datës 14.02.2019, për shumën prej 1,196.39 euro.

Po ashtu, Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e shkallës së parë ka konstatuar se pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit në prapësim dhe përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe duke marrë për bazë dhe vërejtjet sipas aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Ac.nr.5824/20 të datës 21.02.2022, me të cilin e ka aprovuar ankesën e kreditorit si të bazuar duke anuluar aktvendimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Mitrovicë PPP.427/2019 të datës 17.07.2019, e duke iu referuar dispozitave në arsyetimin e Gjykatës së Apelit, gjykate erdhi në përfundim se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar, andaj të njëjtin duhet të aprovoj pjesërisht dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka marr aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozitat e procedurës përmbarimore. Gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se në shkresat e lëndës konstatohet se pretendimet në prapësim janë pjesërisht të qëndrueshëm, sepse i plotëson kushtet ligjore në kuptim të nenit 29 dhe 37 të LPP-së. 4 të LPP-së, rrjedhimisht nuk janë përmbushur asnjë nga kushtet ligjore për anulimin e urdhërit të përmbarimit të përcaktuar me nenin 69 dhe 71 të LPP-së.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Po ashtu, kjo gjykatë vlerëson se nga shkresat e lëndës se Gjykata e shkallës së parë drejt ka vendosur si, kur ka gjetë se kërkesa e kreditorit për faturat nga data 02.11.2015 deri me datën 02.01.2016, është parashkruar, andaj pjesërisht e aprovoi si të bazuar prapësimin e debitorit për shumën prej 1,196.39 €, dhe e anuloi urdhërin për përmbarim P.nr.228/19 të datës 14.02.2019 të Përmbaruesit Privat Atip Mustafa, dhe vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi. Ndërsa sa i përket borxhit sipas faturave për periudhën kohore 01.02.2016 e deri me datë 18.01.2019, në shumën prej 22,211.87 €, gjykata gjeti se i njëjti është i bazuar dhe nuk ka parashkrim të borxhit të kreditorit në raport me debitorin për këtë periudhë kohore duke ju referuar nenit 355 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Ligji Nr.04/L-077), në të cilën parashihet afati 3 (tre) vjeçar i parashkrimit për kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve lidhur me këto kontrata, ndërsa parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer, e që në rastin konkret për secilën nga kërkesat sipas faturave për periudhën prej 01.02.2016 e deri me datë 18.01.2019, nuk kemi kalim të afatit të parashkrimit, për faktin se kreditori me datë 14.02.2019, ka ushtruar propozim për përmbarim, me çka ka shkaktuar ndërprerjen e rrjedhës së afatit të parashkrimit konform nenit 369 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Meqenëse në rastin konkret është vërtetuar se debitori ka mbetur borxh ndaj kreditorit për shumën e cekur në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, gjykata lidhur me këtë pjesë të kërkesës së kreditorit e refuzoi prapësimin e debitorit dhe e la në fuqi urdhrin për lejimin e përmbarimit P.r.228/19 të datës 14.02.2019 të Përmbaruesit Privat Atip Mustafa, për shumën prej 22,211.87 €, pasi që vlerësoi se borxhi për këtë shumë nuk është parashkruar. Gjykata vendosi që të mbetet në fuqi urdhëri i përmbaruesit privat edhe në pjesën lidhur me kamatën prej 8%, dhe atë duke u bazuar në nenin 382 të LMD-së me të cilin përcaktohet se: *"Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën"*, për faktin se debitori ka rënë në vonesë për përmbushjen e detyrimit në shumën prej 22,211.87 € me çka rezulton se kreditorit i takon e drejta për kamatëvonesë lidhur me këtë shumë që nga momenti kur faturat janë bërë të arritshme për pagesë e deri në pagesën definitive nisur nga fakti se në rastin konkret gjykata ka

aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit duke u bazuar në nenin 12 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën përmbartimore, me të cilin përcaktohet se: *"Në rast se e aprovon prapësimin, gjykata varësisht nga rrethanat e rastit e përfundon përmbartimin në tërësi ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera"*, gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit, dhe e përfundoi pjesërisht procedurën e përmbartimit.

Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë i vlerësoi edhe pretendimet ankimore të palës kreditore, mirëpo të njëjtat i refuzuar si të pabazuar dhe të pa mbështetura në shkresat e lëndës.

Andaj, Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vlerësuar gjendjen faktike dhe nuk ka vepruar me shkelje të dispozitave me rastin e vendosjes si në aktvendimin e ankimuar.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 208 dhe 209 pika b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhomat e shkallës së dytë

K.Dh.shk.II.nr.258/24, me datë 19.03.2024

Gjyqtarja,
Franciska Zhitija Ymeri